REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA**

**AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

DREJTORIA PËR ZHVILLIMET NË TERRITOR

Nr. 2703/2 Prot. Datë 09.06.2023

**Lënda:** Dërgohet **Vendimi i KKT-së Nr.04, datë 08.03.2023** *"Për miratimin e Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: "Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë - Vorë - Kashar", me vendndodhje në Bashkitë Tiranë, Vorë dhe Krujë, me subjekte zhvilluese Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, koncesionarin "Gener 2" sh.p.k dhe shoqërinë koncensionare "G2 Infra" sh.p.k.*

**ARKIVIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

**KRYEMINISTRIA**

**ARKIVIT QENDROR TEKNIK TË NDËRTIMIT**

**TIRANË**

**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**TIRANË**

**SHOQËRISË KONCENSIONARE "G2 INFRA" SH.P.K.** ✓

**TIRANË**

Të nderuar,

Në mbledhjen e datës **08.03.2023,** Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar **Vendimin Nr.04,** *"Për miratimin e Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: "Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë - Vorë - Kashar", me vendndodhje në Bashkitë Tiranë, Vorë dhe Krujë, me subjekte zhvilluese Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, koncesionarin "Gener 2" sh.p.k dhe shoqërinë koncensionare "G2 Infra" sh.p.k.,* në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Lidhur me sa më sipër, Ju lutem gjeni bashkëngjitur kopjet origjinale të:

- **Vendimit të sipërcituar,** të sigluar nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e Sekretarit të KKT-së.
- **Hartës së Planvendosjes së Strukturave, Loti 1,** (pjesë përbërëse e vendimit në fjalë), të sigluar nga Kryetari i KKT-së dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Ledia TOTA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT KRYEMINISTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# VENDIM

Nr.04, datë 08.03.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS: "NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR THUMANË - VORË - KASHAR", LOTI I, II, III DHE IV ME VENDNDODHJE NË BASHKITË TIRANË, VORË DHE KRUJË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, koncesionarin "Gener 2" sh.p.k dhe shoqërinë koncensionare "G2 Infra" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: "Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë - Vorë - Kashar", Loti I, II, III dhe IV, me vendndodhje në Bashkitë Tiranë, Vorë dhe Krujë, me subjekte zhvilluese Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, koncesionarin "Gener 2" sh.p.k dhe shoqërinë koncensionare "G2 Infra" sh.p.k.

2. Hartat e Planvendosjes së Strukturave për secilin Lot, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.

3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues sipas Loteve të poshtëshënuara

    - Loti I, Km 0+000 deri në Km 8+500;
    - Loti II, Km 8+500 deri në Km 14+275;
    - Loti III, Km 14+275 deri në Km 20+250;
    - Loti IV, Km 20+250 deri në Km 21+048.

    vetëm pas:

    a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
    b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkive Tiranë, Vorë dhe Krujë.

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

